

Sherif DELVINA

**RELACION MBI GJENDJEN E SHQIPËRISË
DHE TË SERBISË¹ TË VIZITUARA NGA
VINCENC ZMAJEVIÇ, ARQIPESHKV I
TIVARIT, NË VITIN 1703
(Marrë nga Albanische Forschungen. Band 20, Munchen 1979)
VON PETER BARTL**

Të dhëna të përgjithshme të gjendjes së Shqipërisë dhe të veprimtarisë së Imzot Vincenc Zmajevič, Arqipeshkëv i Tivarit, Vizitor Apostolik i Shqipërisë.

Në fillim të këtij relacioni, arqipeshkvi i Tivarit, Vincenc Zmajeviči, jep shtrirjen detare të Shqipërisë, që nis nga Pastroviçi, kufiri i fundit i Republikës së Venedikut dhe mbaron te Gjiri i Ambrakisë. Autori na bën të ditur se të krishterët e këtij vendi pjellor do të gëzonin tërë të mirat e kësaj bote, po të mos u binin në qafë me taksa të rënda turqit. Prandaj, vijon ai, ata kanë humbur dashurinë për kultivimin e tokës, mjeti i tyre i vetëm i jetesës, duke mbajtur kështu pjesën më të madhe të tokës të papunuar. Nga këto taksa, kombi është plagosur në pjesën e tij më të dobët, atë të interesit, ndaj të cilit është veçanërisht i prirur ky komb nga ana e karakterit të tij ose nga nevoja. Për shkak të këtyre taksave, mendon autori, u bënë kthimet nga feja katolike në atë muslimane dhe, çka është më e keqe, humbëm dymijë veta që u kthyen në muslimanë për t'u shpëtuar taksave.²

Në kohën kur erdhi për inspektim Vincenc Zmajevič, një pjesë e mirë e Shqipërisë qeverisej prej Oda Verdi Mahmut Begolli nga Peja. Pashai në fjalë e priti mirë arqipeshkvin e Tivarit. Këtij i bëri mjaft lëshim edhe në uljen e taksave, të cilat, në një pjesë të Shqipërisë, kapnin shumën e 350 zekineve venedikase. Po ashtu, ai lëshoi një dekret, në të cilin thuhej: "...Të gjithë zëvendësit e mi që

do të gjenden në vasalitetet e Shkodrës dhe të Dukagjinit, të mos u krijojnë telashe ipeshkëve dhe priftërinjëve. Të gjithë këta gëzojnë të drejtën e plotë të mësojnë të krishterët pa pasur kundërshtimin e kurrkujt. Ata mund të shkojnë kudo për të vizituar të krishterët dhe të kryejnë të gjitha veprimet që urdhëron ligji i tyre. Për këtë qëllim kam shkruar këtë urdhër, duke ia dhënë arqipeshkvit, mikut tonë të mirë, dhe, kudo që do të paraqitet urdhri, të gjithë duhet t'i binden!" Mirëpo arqipeshkvi i Tivarit, pasi e lavdëron këtë pasha, në relacionin e tij pohon se ky nuk dukej si turk (shqiptar musliman), por si i krishterë zemërbardhë që nuk kishte asgjë prej barbari, veçse emrit të tij.

Le të citojmë disa të dhëna për konvertimet që janë nxjerrë nga relacioni në fjalë:

I. Në rrethinat e Tivarit, në shtëpinë e moçme dhe të mirënjohur fisnike Boriçi, dy vëllezër kanë dy fe të ndryshme: njëri nga feja katolike u kthye në musliman për shkak të premtimeve që i bënë turqit, ndërsa tjetri qëndroi katolik, sepse e shpëtoi vetë arqipeshkvi. Ai tashti pret nga Kongregacioni i Shenjtë të pranohet në ndonjë kolegji apostolik dhe pastaj, duke dalë me sukses në studime, të ndihmonte krishterimin e atij vendi, po ashtu të justifikonte vlerësimin që i bëjnë turqit (muslimanët shqiptarë) shtëpisë së tij, megjithëse e varfër, por nga të gjithë e respektuar.³

II. Në famullinë e Subcit, që ndodhet në rrethinat e Tivarit, turqit marrin me dhunë gra të krishtere, të cilat pastaj ushtrojnë ritin katolik në kishë gjatë kohës së këtij bashkimi të paligjshëm.⁴

III. Në fshatin Teliki të rrethit të Tivarit vihet në dukje se gjendeshin katër shtëpi katolike me 31 vetë me kishën e Shën Aleksandrit në gjendje të mirë materiale. Në këtë fshat ndodheshin 3 apostatë (tre fshatarë katolikë të kthyer në fenë islame). Gjatë vizitës sonë ata e kuptuan gabimin dhe u kthyen në gjirin e kishës, kurse dy të krishterë të fshehtë, që në ambientet e jashtme paraqiteshin si muslimanë, ndërsa fshehtazi vazhdonin të ishin të krishterë, publikisht deklaruan se ishin të krishterë...⁵

Banorët e Malësisë kanë veset e tyre të veçanta: janë të prirur për seks, marrin grua me provë, pa bërë martesë në kishë dhe, pas shumë vjetësh bashkëjetese të paligjshme, me pëlqimin edhe të prindërve të cilët janë shkaku i të gjitha të këqijave, janë pranuar nga disa priftërinj të marrin pjesë në sakramentet...⁶

IV. Famullia e Riolit është keqësuar shumë nga apostazitë (kthimet në fenë islame). Aty janë kthyer në gjirin e fesë shumica e reneгатëve (femohuesve). Shpresojmë se këtë shembull do ta ndjekin edhe të tjerët, sepse u është mohuar me urdhër të Sinodit marrja pjesë në sakramentet, që është shkak kryesor i konvertimeve fetare (në fenë islame – Sh.D.).⁷

V. Në vitin që shkoi, kryetarët e familjeve në 8 fshatrat e Kastratit u kthyen në muslimanë, por, me të dëgjuar rezolutën e Konçilit, që i la pa sakramente, mohuan në mënyrë solemne gabimin e konvertimit në fenë islame duke vendosur të vazhdojnë t'i përkasin fesë së krishterë.⁸

VI. Në 5 fshatrat e Hotit gjendet vetëm një kishë, por, megjithse krerët e shtëpive janë kthyer në muslimanë për shkak të taksave, pas urdhrorit të lëshuar kundër femohuesve dhe të krishterëve të fshehur, duket që kanë ndërruar mendim, pasi janë kthyer përsëri në fenë e krishterë.⁹

VII. Në fshatrat e Pukës, prifti D. Gjergj Krizjo ish i dënuar nga Mahmut Pasha, ka rikthyer në fenë katolike 120 apostatë (të krishterë të kthyer me dhunë nga Mahmut Pasha). Ai banon në shtëpinë atërore në fshatin Kërçira, se famullia nuk kishte vendstrehim. Këto kthime, na bën të ditur autori, ai i ka kryer duke shkuar katër herë në vit në fshatrat e Pukës.¹⁰

VIII. Kur flet për arqipeshkvinë e Durrësit, V. Zmajeviçi i lutet Perëndisë që të falë MonsinJOR Gallatën, paraardhësin e arqipeshkvit të tanishëm, që vinte klerikë të paaftë në famullitë dhe lejonte të merrnin pjesë në sakramentet apostatët dhe të krishterët e fshehtë, të cilët janë dy shkaqet kryesore që dëmtuan fenë e krishterë në Shqipëri.¹¹

IX. Bogomeshi është katër milje larg qytetit të Krujës. Drejt lindjes është plot me ullinj, kjo mbështetje e vetme e besimtarëve. Numëron dhjetë shtëpi me 83 veta, të cilët janë shumë të qëndrueshëm në fe. Pesëmbëdhjetë hapa nga kisha gjendet shtëpia e famullisë. Prifti Pjetër Bogomeshi shërben në këtë fshat dhe, po ashtu, ndihmon dy shtëpi të krishtere në fshatin Borileci, dy milje larg kishës së Shën Mërisë Yllindëse. Fshatrat përreth, 30 vjet më parë banoreshin vetëm nga të krishterë, kurse sot të gjitha këto fshatra janë bërë turke (muslimanë shqiptarë) Atje shihen edhe

kisha në gjendje të mirë, si ajo e Shën Mërisë, Shën Gjon Pagëzorit dhe Shën Andresë.¹²

X. Vincenc Zmajeviči thotë se në Sumanji duken mbeturinat e kishës së Shën Ilisë, e cila dikur mbushej plot me të krishterë, kurse sot, për shkak të apostazisë, ka mbetur me shumë pak besimtarë.¹³

XI. Kur përmendet kisha e Shën Stefanit në Radë, pohohet se 17 fshatra të afërt nga ajo janë kthyer në fenë islame.¹⁴

XII. Shkupi, na bën të ditur autori, është djegur në luftën e shkuar nga gjermanët dhe rindërtuar nga turqit. Sot Shkupi ka rreth 20 000 shtëpi me rreth 50 xhami, prej të cilave 27 me strukturë të madhërisme dhe të mbuluara me plumb. Në Shkup gjenden plot mallra të çdo lloji. Ai është qendër tregtare e gjithë Perandorisë Osmane dhe banohet nga turq, çifutë, grekë dhe, në pjesën më të vogël të tij, prej katolikësh, ku në nëntë shtëpi numrohen 52 vetë.¹⁵ Vlen të theksohet se, kur autori flet për banorët turq të Shkupit, duhet të kuptojmë që pjesa dërrmuese e tyre janë muslimanë shqiptarë.

XIII. Janjeva ka shtrirje të madhe. Misioni i kufizuar në kufijtë e lumit Moravë e Vuçitern në rreth katër ditë udhëtimi përfshin 20 vendbanime, midis tyre vetë Janjeva, Prishtina, Vuçiterna etj. Në këtë zonë gjenden 403 katolikë. Autori vë në dukje se në shumicën e këtyre vendeve është marrë për bazë feja që ushtrohet nga kryetari i familjes. Në vendet e sipërpërmendura shtëpitë cilësohen turke (shqiptare muslimane), ndërsa numri i të krishterëve del vetëm nga numri i grave të krishtera si edhe i ndonjë djali, vihet në dukje në relacion.¹⁶

XIV. Gjakova me 26 qendra banimi, ka 58 shtëpi me 446 katolikë. V. Zmajeviči shënon se shumica e banorëve ka kaluar në fenë islame dhe pak prej tyre i kanë qëndruar besnikë fesë, përveç grave të tyre që janë shumë të qëndrueshme ndaj fesë së vërtetë.¹⁷

XV. Autori i përmendur vë në dukje se në Pejë të krishterët janë pakësuar për shkak të apostazive të shkuara të cilat u bënë për motive taksash. Pothuajse në çdo shtëpi gjenden të përzier, d.m.th. muslimanët shqiptarë me katolikët shqiptarë (në një familje).¹⁸ Peja përfshin 52 vendbanime, shtëpi katolike 322, besimtarë katolikë 1623. Peja (qytet) ka 11 shtëpi katolike dhe 33 besimtarë katolikë.

XVII. Të bën përshtypje që në Sofje (kryeqyteti i Bullgarisë

dhe seli arqipeshkvie) kanë mbetur 7 shtëpi katolike me 22 veta. Françeskani, at Francesko Gaeta, që i ndihmon besimtarët, dyshohet se është apostat.¹⁹

Nikolla Sosina

XVIII. Në këtë relacion, për rrezik kthimi në fenë islame, jepet një shembull interesant. Citojmë: “Nikolla Sosina, prift i framullisë së Borgos (lagjes periferike) e qytetit të Tivarit, katolik me zakone shembullore, pati fatkeqësinë që të përjetojë pesëmbëdhjetë vjet më parë katër vëllezërit e tij të kthehen në fenë islame. I vetëm, por i fortë shpirtërisht, mbeti në fenë katolike dhe u bë kryetar i farefisit të tij të madh për ta ruajtur e shpëtuar prej atyre që kërkonin t’i kthejnë bashkatdhetarët e tij në muhamedanizëm (fenë islame), por, fatkeqësisht, kur prifti Nikolla ruante të tjerët që të mos ktheheshin në muslimanë, ra në gabim: mori për grua të dytë Maria Matesiçin. Për këtë protestoi famullitari i asaj kohe, mirëpo pa rezultat, por jo pa shpresë në korrigjimin e tij. Nga ky bashkim i paligjshëm ai pati disa fëmijë. Nikolla e ka të pamundur ndarjen nga Maria, pse kjo gjë do t’i kushtonte me jetë. I katandisur në këtë gjendje dëshpërimi, është në rrezik të braktisë fenë katolike për të shpëtuar në këtë mënyrë nga turpi i të pasurit fëmijë jolegjitimë, të cilët kthehen në legjitimë sipas ligjeve turke, nëse i ati i tyre (Nikolla Sosina) ndërron fenë duke u kthyer në musliman. Kthimi i tij në fenë islame do të sillte rrënimin e njëzet e më shumë familjeve të farefisnisë së tij, të cilat deri tashti kanë shpëtuar nga rreziqet, përkëdhelive dhe dëshirave për t’u dukur përfituese të turqve...”²⁰

XVIII. Për kthim me dhunë në fenë islame pohohet se pashai i ri i Ohrit, që qeverisi Maqedoninë, është djali i të paudhit Oxhioglu, persekutori më i madh që ka provuar feja katolike në këto anë, dhe që e ka ushtruar talentin e tij barbar në këtë krahinë. “Me dhunë të pazakontë ka bërë një turk për çdo shtëpi në Misionet e Pishkashit, të Macukllit, të Qidhnës dhe në famullinë e Lurës, e cila ka qëndruar deri tashti më e sinqerta në pastërtinë e fesë katolike. Fillimi është shumë i keq dhe i rëndë, me rrjedha shumë të rrezikshme. Të kthyerit e rinj në fenë muslimane janë kryetarë familjesh, të cilat, me kalimin e kohës që të gjitha do të bëhen turke, nëse mëshira hyjnore nuk gjen ndonjë përkrahje nga ndërhyrja e

Perëndisë." Në të vërtetë, nuk është ashtu siç thotë V. Zmajeviçi për kthimet me dhunë. Teqeja e Murat Dedës në Lurë ka gëzuar dhe gëzon autoritet të madh në ato anë. Vëllazërimi midis fesë islame dhe asaj të krishterë ka kapur majat më të larta. Shehu, hoxha dhe prifti katolik zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet, harmonia fetare është e plotë. Besimtarët katolikë të Lurës vazhdojnë të praktikojnë fetë e tyre muslimane dhe katolike.²¹

Autori i relacionit është i mendimit se malet janë ato që pengojnë apostazinë. Është qesharak ky mendim i tij, përderisa ai nuk është në gjendje të kuptojë e shpjegojë faktin se si dhe pse u konvertuan në fenë islame banorët e maleve më të larta të Shqipërisë.

Injoranca e klerit katolik në Shqipëri

Në relacionin e arqipeshkvit të Tivarit shpesh flitet për injorancën e klerit katolik në Shqipëri. Për këtë vëmë në dukje disa raste të konstatuara prej tij. Në fshatin Barbullush shërbejnë dy famulltarë, D. Mark Xugarini dhe D. Gjergj Suma. I pari është 31 vjeç, klerik injorant dhe kolerik, i dyti është i së njëjtës moshë, i urtë, zemërbutë, por shok i të parit në injorancë. Kur flet për gjendjen e ipeshkvisë së Lezhës, relatori në fjalë thekson se kleri ndodhet në çrregullim më të madh, se i tëri është i infektuar (me pak përjashtime)...dhe është dhurata e veçantë e Perëndisë që me këta klerikë jo vetëm injorantë, por edhe të padisiplinuar, janë ruajtur në fenë e tyre të krishterët e varfër.²²

Në fshatin Zejmen, vijon V. Zmajeviçi, gjenden tre famulltarë të pazellshëm në shërbim të famullisë, të dhënë pas interesit të tyre dhe që nuk dinë të shkruajnë. D. Mark Rioni, i mirë, plak, por i paaftë për punët e kishës, D. Gjergj Skac, i 36 vjeç, kolerik, tipi i klerikut të pabindur, pak i aftë si famullitar, i cili është futur në kishë me anën e ndërhyrjes prepotente të komandantit turk të Lezhës. I kësaj kategorie është dhe Andrea Trushi, 32 vjeç, por më i bindur se të tjerët. Këta jetojnë në shtëpinë e famullisë, komode për të tre, me dhoma të veçanta për secilin.²³

Le të shohim famullitarët e fshatit Kurbin: I pari, D. Martin Busalla, nxënës i kolegjit të Feros, 38 vjeç, inteligjent, i aftë, është zëvendës i arqipeshkvit, mësues shkolle, me rrogë 25 skuda vjetore, i përpiktë në kishë, ka mësuar katër klerikët vetëm për të

lexuar e jo për të shkruar, një rrugë kjo e hapur nga paraardhësit e tij. Kleriku i dytë është D. Primo Prodani, injorant, që di vetëm të lexojë. I treti është D. Primo Skiezi, edhe ky nuk di të shkruajë, tip kleriku i xhindosur, i paaftë në vuajtje, ka vvarë dy turq duke u bërë kështu i çrregullt.²⁴

Në famullinë e fshatit Selitë gjendet famullitari tetëdhjetëvjeçar D. Lazar Dajçi, me defekte në të gjitha punët e famullisë. Është injorant dhe i shurdhër...

Në fshatin Sebaste gjenden katër etër françeskanë: at Nikolla Kallmeti, 42 vjeç me 20 vite në shërbim si klerik, at Thomaj nga Pëdhana, vjeç 55 dhe me 32 vjet në shërbim fetar, at Pjetri nga Kodheli, vjeç 30, si dhe prifti Françesk prej Shiroke 25 vjeç. Që të gjithë janë injorantë dhe nuk dinë të shkruajnë, jetojnë si pronarë, janë pak të bindur ndaj superiorëve, nuk njohin detyrat e tyre etj., ushtrojnë detyrën në pesë fshatra që kanë gjithsej 257 katolikë.²⁵

Në fshatin Gurëzi është famullitar D. Mark Baruch, 44 vjeç, i sëmurë, injorant dhe pothusje i paaftë, i toleruar në këtë punë nga nevoja dhe mungesa shumë e madhe e priftërinjve, banon në shtëpinë e famullisë, që është më e madhja dhe më komodja e atyre që gjenden në Shqipëri.²⁶

Në fshatin Redon gjenden at Buonaventura, vjeç 67, injorant, dhe prift Zefi nga Troshani, 23 vjeç, stazhier i mirë, i cili është si gjithë nevojtarët e tjerë për reformë.²⁷

Në Has, misionar i sotëm i paguar nga Kongregacioni i Shenjtë është Don Mark Bardhi, i ri 34 vjeçar, tashmë misionar prej Gjakove, me zakone të mira, por me zgjuarsia mediokre, i cili, duke mos ditur të shkruajë, sjell pasojën e vajtueshme që ky klerik të mos ketë mundësi të studiojë atdheun e tij, Shqipërinë.²⁸ Lexuesit i vjen keq kur lexon faqen 142 të këtij relacioni, ku thuhet: "Injoranca e klerit dhe shkatërrimi i popullit, si njëra, si tjetra eksperimentohen në të varfrën Shqipëri.²⁹ Vizitori apostolik gjen famullitarin Don Lllazar Prelin, 50 vjeç, që nuk di të shkruajë, por që pretendon se ka praktikë në astrologjinë gjyqësore dhe se e ushtron atë. Megjithatë u ndëshkua, përsëri ky prift u rivu po në atë vend për nevoja ekstreme si famullitar.³⁰ Është e drejtë të pyesim: A ka më antifetar se astrologu? A është e mundur të jetë prifti një njeri i tillë?"

Mungesat dhe rrugëdaljet për etërit françeskanë

“Etërit françeskanë të Provincës së Shqipërisë nga ana fetare kanë vetëm emrin dhe rrobën si të tillë. Injoranca është shkaku i të gjitha të këqijave të tyre. Prej këtyre etërve vetëm njëri di të shkruajë. Në kohët e mëparshme këta i dërgonin në Itali për të mësuar profesionin e klerikut, por, të tërhequr nga ajo klimë e mirë, këta nuk ktheheshin më në atdheun e tyre. Midis vërejtjeve që iu bënë etërve në dekretet e Konkilit, njëra ka qenë që ata të detyroheshin të ktheheshin në vendlindje me anë të betimit të bërë më parë, sepse nuk gjendej një mënyrë tjetër më e përshtatshme.” (faqja 144 e relacionit të sipërcituar)³¹

Gjendja në Ipeshkvatën e Lezhës

Në këtë ipeshkvi, thuhet në relacion, ka çrregullim dhe korrupsion të madh, si dhe injorancë dhe mungesë discipline. Ipeshkvi, monsinjor Nikollë Vladanji, është më i shkathët dhe më inteligjent se prelatët e tjerë, por më pak i zellshëm në punët e ipeshkvisë. Cilësitë e tij vetjake janë bërë të ditura në Koncil, veçanërisht në kapitullin e ipeshkëve, ku pohohet se në të gjitha anët është difektoz, shihet me sy të keq dhe urrehet nga të gjithë besimtarët e dioqezës për shkak të dhunës së ushtruar në fukarenjtë, të cilëve u kërkon pjesën e grurit, të verës e të djathit dhe, po nuk ia dhanë, i lë pa sakramente dhe nuk i lë të hyjnë në kishë. Dhe këtë e bën me një ashpërsi të tillë duke i lënë të vdesin pa sakramente. Por, vë në dukje V. Zmajeviçi, kjo akuzë e fundit nuk u provua, bile nuk u provua dhe akuza që i drejtohej atij për marrëdhënie me një grua të martuar. Arqipeshkvi i Tivarit e shpëtoi nga kjo akuzë ipeshkvin duke e dënuar me çkishërim atë që do t'i binte në qafë për një motiv të tillë. V. Zmajeviçi konkludon me të drejtë për këtë ipeshkëv duke theksuar se ka pak shpresa që të korrigjohet, sepse tek ai mbizotëron së tepërmi i mallkuari interes që e largon pothuajse krejtësisht nga detyrat e rëndësishme të ipeshkvisë.³²

Një akt tjetër i Monsinjor Ipeshkvit, që kish humbur dashurinë e popullit, ishte sjella e tij me kishën e Shën Dhimitrit në fshatin Trish. Ipeshkvi në fjalë, kur kishte shkuar në Venedik, kishte

rregulluar kambanën e kësaj kishe, por ai nuk ua jepte atë fshatarëve të atyre anëve, pa i shlyer taksën e një xekini për shtëpi. Vizitori apostolik e rregulloi gjendjen, duke bindur ipeshkvin, i cili ia dhuroi kishës këtë kambanë për mëshirë kishtare.

Në kishën e sipërpërmendur, na bën të ditur vizitori apostolik, punon Paolo Reda, 35 vjeç, i paaftë dhe injorant si gjithë të tjerët në punët e famullisë. Kështu ai popull ka mbetur pa fjalën mirëbërëse të Perëndisë, pa u udhëzuar për çështjet fetare. Të gjitha këto nuk jepen pa përfitim nga famullitari për shkak të injorancës së tij. I gjithë populli është kundërshtar i këtij ipeshkvi, të cilin, në prani të vizitorit, e quajti ujk për ushtrim dhune në marrjen e taksave. Populli u ngrit kundër ipeshkvit të sipërpërmendur, i cili u bind nga vizitori (Vincenc Zmajevic - Sh.D.), kështu që ipeshkvi dorëzoi bereqetin dhe populli u qetësua.³³

Edhe në Malin e Zi (që sot i përket rrethit të Kukësit) ndodhin kthime në fenë islame, sepse ipeshkvi, N. Vlladanji, i ka lënë pa famullitar qysh prej tre vjetësh për t'i detyruar të paguajnë një taksë prej 10 bajokësh për shtëpi. Mali i Zi në atë kohë përbëhej prej 14 fshatrash.

Një gjë tjetër që bie në sy në këtë relacion është nepotizmi. Këtë e vë në dukje fare mirë V. Zmajevici duke thënë se nderi i mitrës (kësulës së ipeshkvit) bie mbi faresin e vet dhe për këtë angazhohet i gjithë fisi. Vladanët janë më të pasur dhe më të dhunshëm në ushtrimin e detyrave kishtare.

Famullia e fshatit Dukagjin administrohet nga D. Dhimitër Vranani, i cili akuzohet për marrëdhënie me gra të martuara, e kalon kohën në gosti dhe në qejfe, është dhe i pazellshëm në shërbim të famullisë.³⁴

Në këtë ipeshkvi, vë në dukje arqipeshkvi i Tivarit, gjendet dhe Fani i Vogël, i përbërë prej pesë fshatrash, në famullinë e Shën Markut. Aty gjenden Don Mark Skura dhe Don Primo Skura. I pari është 38 vjeç, me natyrë të dhunshme dhe që nuk di të shkruajë, i dyti është 27 vjeç, di pak të lexojë, por ka dëshirë të mësojë. Ata mund të jetojnë mirë, por pangopshmëria i bën të pakënaqur. Gjithmonë janë të pazellshëm në mjaft detyra të famullisë. Popullin e Fanit të Vogël vizitori apostolik e këshilloi që të linte disa gosti skandaloze që shtronte në famulli.³⁵

Famullia e Veljës përmbledh tri fshatra dhe atje shërben një

famullitar shembullor, D. Aleksandër Zhupa, i çmuar nga turqit (muslimanët shqiptarë) dhe të krishterët. Ky klerik shkon edhe në gjykatoret turke për t'i mbrojtur fshatarët nga taksat e pareshtura dhe me shkathtësi ua ul taksat. Ai e shpëtoi ipeshkvin nga kërcënimi me vdekje prej turqve për shkak të korrespondencës së tij politike në kohën e luftës së Perandorinë Osmane me Austrinë. Ai e administron famullinë. Autori pohon se vetëm famullitari A. Zhupa shkruan në Shqipëri pagëzimet, martesat, emrat e të vdekurve, vë të rrëfihen djemtë dhe bën çdo gjë që duhet, megjithëse nga të tjerët është lënë pas dore dhe, çka është më e çuditshme, urrehet nga ipeshkvi për shkak xhelozie.³⁶

Patrikana e Pejës dhe armiqësia ndaj klerikëve

Relatori thekson që Patriku i tanishëm, Kaleniku (patrik i Pejës 1691-1710), është armiku më i ashpër që ka feja jonë. Ai ka siguruar dhe marrë urdhrat nga qeveria për të dëbuar misionarët katolikë, për t'i detyruar famullitarët të japin kontributin vjetor të një xekini për kokë, për t'i nënshtruar katolikët duke i vënë secilit taksën vjetore të një dukati, si edhe kushtet më të vështira për atë që dëshiron të martohet, sepse duhet të paguajë 5, 6 deri në 10 dukate sipas mundësisë për çdo katolik që të martohet. Në përfundim, autori pohon se nuk kemi kujt t'i drejtohem, Oda Verdi Mahmudbegoviçit, përderisa Kalenikun e përkrah Nicolaos Mavrokordatos (1680-1730), kryedragoman i Portës së Lartë!³⁷

Më vonë, në vend të Pashajt Oda Verdi Mahmudbegoviç erdhi nipi i tij, Tahir Pasha Mahmudbegoviç. Arqipeshkvi i Tivarit, Zmajeviçi, i kërkoi këtij të ndërhynte kundër padrejtësive që u bënte katolikëve patriku Kalenik. Citojmë përgjigjen që i dërgon Tahir Pasha Mahmudbegoviçi atij:

“Shumë të dashurit dhe mikut të vjetër të shtëpisë sonë, Zotit arqipeshkëv V. Zmajeviç, kryetar i të gjithë ipeshkëve, priftrinjeve, murgjve dhe të krishterëve të këtyre anëve, përshendetje dhe nderim të thellë. Pasi morëm dy letra nga shkëlqesia Juaj, njërën me anën e së cilës na shprehnit dashurinë e vjetër të zemrës suaj si dhe gëzimin që sulltani ne na ka vënë të sundojmë këtë vend si më parë, ne e falenderojmë shumë shkëlqesinë Tuaj dhe i lutemi Perëndisë për shëndetin dhe për zotërimet Tuaja, që një herë tjetër,

të mund të shihemi dhe t'i shërbejmë njëri-tjetrit.

Morëm letrën e dytë që solli korrieri Juaj, në të cilën Ju rekomandonit këta murgjër si edhe shtëpinë e tyre të re. Ne, menjëherë folëm me kapixhinë dhe, për dashurinë që kemi për Ju, iu lutëm duke i dhënë shumë dhurata që ta realizonte kërkesën Tuaj. Kërkuan, kështu, që murgjët të mbeten të qetë deri sa Perëndia të na u japë jetë. Ne do t'i mbrojmë gjithmonë për dashurinë që kemi ndaj jush. Por ky qen dhe jo Patrik Kalenik, njeri i keq dhe i përdalë, nuk ka zbatuar urdhrin e sulltanit duke kërkuar nga murgjët që t'i paguajnë taksën. Ne çuam një njeri tonin së bashku me murgjët te Kadiu (gjykatësi) që të mos lejojë të zbatohet urdhri i Kalenikut dhe kështu bëri ai, por i djallëzuar Patrik dërgoi me shpejtësi një njeri të tij te bejlerbeu i Rumelisë, i cili është eprori ynë dhe nuk dimë çfarë do të bëjë. Ne do të mbrojmë, Zoti ju ruajtë jetën, shëndetin dhe zotërimet.”³⁸

Arqipeshkvi i Tivarit, V. Zmajeviçi, në një relacion që i dërgon Kardinalit Sakripante nga Perasto, më 20 nëntor 1704 (APF SOGG. vol.550, f.419-422), ndërmjet të tjerash vë në dukje se kisha e Shën Kollit e dioqezës së Tivarit me kapelan katolikun tonë Nikollë Medin, befas dhe me prepotencë u pushtua nga peshkopi i Cetinjës, Danilo Petroviç Niegosh dhe, pa asnjë bazë, me arsye të paqena dhe tradita të sajura, e shenjtëron dhe e lidh këtë kishë katolike me ritin e tij skizmatik. Skizmatikët prepotentë, të nxitur nga pseudopeshkopi, i cili nuk pushon së kërcënuari jetën time, më kërcënojnë, por Zoti hirplotë, me Mëshirën e tij, mua, që gjendem në mes të turqve, më ka ndihmuar. Po ashtu, Perëndia më ka mbrojtur deri tashti nga skizmatiku i lartpërmendur.”

Arqipeshkvi i Tivarit vë në dukje se dy krishterë të dioqezës së Tivarit apostuan (ndërruan fe) për t'i shpëtuar vdekjes për shkak të një vjedhjeje që kryen këta dhe që përfundoi me vrasjen e një skizmatiku (ortodoksi). Është për të vënë re se në këtë rast nuk vihet në dukje se në çfarë feje u kthyen këta dioqezianë, në atë ortodokse apo në atë muslimane.

Patrikana serbe e Pejës në atë kohë ushtronte trysni të madhe ndaj misionarëve fetarë, duke kërkuar pranë autoriteteve osmane dëbimin e tyre. Këtë e vë në dukje përsëri V. Zmajeviçi në një letër dërguar Selisë së Shenjtë (APF, Sogg vol.554. f.157,157r, 159) Po citojmë një fragment prej saj: “...Patriku i Serbisë, Kaleniku, i cili

është lartësuar në atë vend nga Perandoria Osmane pasi u dëbua paraardhësi i tij, Arseni, që tashti gjendet në afërsi të Buduas në Hungari. Kaleniku quhet edhe nga skizmatikët patrik fals, por ai njihet legjitim nga turqit që e ndihmojnë me anë të jeniçerëve të armatosur dhe të urdhëruar nga Porta e Lartë.”³⁹

Në APF, SOGG, vol.556, f.213v, 216 pohohet: “Prej kurtheve të endura nga skizmatikët ortodoksë kundër Misionit dhe vendit ku strehoheshin misionarët, vijuan pas ato të turqve, bile edhe të priftërinjve të pabesë skizmatikë, që i sugjeruan Tahir Pashës dëbimin e misionarëve fetarë nga ai vend, duke parë si një gabim të rëndë ngritjen e ndërtesës ku strehoheshin misionarët, që ndodhej në kryeqendrën e asaj province.”

Më tej, V. Zmajeviqi tregon se për mbrojtjen e atij vendstrehimi iu drejtua pashait, nënës së tij, ku dhe qëndronte autoriteti dhe dobësia e djalit të saj (Tahir Pashës). Nëna e tij u interesua dhe e shpëtoi atë vend të shenjtë, shmangu dëbimin e etërve dhe siguroi mbrojtjen e tyre prej saj.⁴⁰

Skizmatikët kishin përkrahjen e Portës së Lartë, kurse katolikët shiheshin me sy të keq, sepse ishin të lidhur me perëndimin. Në Zara, 3 mars 1729 (APF, SOGG, vol.664, f.252), pohohet: “Nëse misionarët zbuloheshin se mbroheshin nga Austria, do të ngjallnin në dëm të tyre xhelozitë e osmanëve dhe kështu do t’u bënë të pamundur misionin duke i përzënë papritur e kujtuar nga misionet dhe gjithë Serbia (Kupto: Serbia = Kosova).”

Për lidhjen e titullarëve katolikë me Austrinë në rast lufte me turqit flet letra e Mikel Sumës dërguar nga Herceku i Sllavonisë më 29 janar 1743, në të cilën vihet në dukje se ai është shuguruar si arqipeshkëv i Shkupit në datën 3 korrik 1729 dhe se “...Atje i kam shërbyer dioqezës me kontrolle, me predikime, si edhe duke u dhënë ndihmë apostateve (felëshuesve) pa u ndarë kurrë nga dioqeza ime duke qenë në paqe me turqit, me grekët dhe popullin që i ishte besuar kujdesit tim deri në atë kohë që ndodhi lufta e pafat në mes të Çezarit (austriakëve) dhe turkut (Perandorisë Osmane), për shkak të së cilës unë u detyrova me një pjesë të krishterëve që ishin nën austriakët, të tërhiqem së bashku me ta nën zotërimin austriak..” Më tej në këtë letër, Mikel Suma, arqipeshkvi i Shkupit, kërkon që të mos kthehet përsëri në detyrë, sepse do t’i bëjë dëme të mëdha popullit dhe

klerit, prandaj u lutet eminencave (kardinalëve) që të denjojnë të pranohet mosmiratimin e tij për t'u bërë përsëri arqipeshkëv i Shkupit. Për këtë ai pohon se “Kardinalët nuk do të gjejnë kurrë vështirësi për të gjetur në vendin tim një subjekt më të mirë se Don Gjon Nikoloviçi, i mirënjohur nga ju, kardinalët dhe në të gjithë dioqezën, si subjekt shembullor i zellshëm në Mision, i dashur nga turqit dhe të krishterët, familjarizuar me vendin e tij, e që zotëron gjuhët arabe, turke, ilirike dhe shqiptare, po ashtu kurrë nuk është ndarë nga populli.”⁴¹

Në Zara, 14 janar 1744⁴², na bëhet e ditur se “Peshkopi serb i Malit të Zi, që prej mjaft vitesh ka vendosur katedrën e qelbët të tij në Pastroviç, në këtë çast gjendet në Moskë. Do të kthehet prej andej plot me ar për të munduar katolikët.” Po në këtë dokument, rekomandohet për arqipeshkëv të Tivarit Don Nikolla Bubiç, nip i Domenik Bubiçit, ipeshkëv i Shkodrës (1676-1686), i cili do të respektohet nga turqit, miqtë e shtëpisë së tij dhe që e kanë frikë skizmatikët, subjekte të autoritetit të vëllait të tij, komandant i territorit të Budvës (atëherë ndën Venedikun).

Nga ç'thamë më sipër, konkludohet se një shkak i fortë për apostazi (kthim në fenë islame nga ajo katolike) ishte edhe lufta që bënin kishat njëra kundër tjetrës.

Në disa fshatra banorët mezi dinë të bëjnë kryqin

Në disa fshatra të Plantit fshatarët mezi dinë të bëjnë kryqin e shenjtë, por u vendos që me dekret të Sinodit, etërit, në stinët më të buta (duke qenë e pamundur që ta bënin këtë në dimër), të shkojnë në të njëjtat fshatra. Pra, sa të kthehet njëri nga etërit, duhet ta ndërmarrë tjetri vajtjen në ato vende. (fq. 52). Kurse në fshatrat e Ndërfandinës, thotë vizitori apostolik, pak veta dinë të bëjnë shenjë e shenjtë të kryqit.⁴³

Vrasje në Ipeshkvatën e Pultit

Për këtë krim le të citojmë autorin: “Në Ipeshkvinë e Pultit shpëtoi për mrekulli administratori Monsinjor Gasparo, të cilit vendasit i morën çka kishte me vete. Don Gjergj Planti pati një fat të kundërt: atë e vranë në fshatin e Sumës. Po ashtu, nga vetë

banorët është vrarë edhe ipeshkvi i Pultit. Pas rënies nga gjendja ekonomike e malësorëve të tjerë, kanë braktisur një pjesë e mirë e tyre ato shpirtrat shtazarakë, që i bënë më të ngjashëm me kafshët se sa me njerëzit. Por ata ruajnë veç vesit të mishit, atë të mbajtjes së më se një gruaje, hakmarrjen, vjedhjen pa kërkuar falje dhe moskthimin e gjësë së vjedhur, po ashtu dhe dy ekstremet, varfërinë dhe ambicien e tyre të madhe. Në pjesën më të madhe të çdo stine janë gjysmë të zhveshur. Meqë vendi është i shterpët dhe u mungon mundësia e jetesës, megjithëse kanë një vlerësim të madh për veten e tyre, ata i kundërvënë robërisë vdekjen, janë të gatshëm që më mirë të vdesin, se sa të bien në robëri.”⁴⁴

shënime:

¹ Të Serbisë: të Kosovës së djeshme dhe të sotme

² fq. 7

³ fq. 17

⁴ fq. 18

⁵ fq. 21

⁶ fq. 25

⁷ fq. 26

⁸ fq. 28

⁹ fq. 29

¹⁰ fq. 71

¹¹ fq. 99

¹² fq. 113

¹³ fq. 121

¹⁴ fq. 121

¹⁵ fq. 129

¹⁶ fq. 130-131

¹⁷ fq. 133

¹⁸ fq. 136

¹⁹ fq. 141

²⁰ fq. 206

²¹ fq. 216

²² fq. 73

²³ fq. 88

²⁴ fq. 102

²⁵ fq. 116

²⁶ fq. 118

²⁷ fq. 119

²⁸ fq. 134

²⁹ fq. 142

³⁰ fq. 106

³¹ fq. 144

³² fq. 74

³³ fq. 89

³⁴ fq. 76

³⁵ fq. 76

³⁶ fq. 90-91

³⁷ fq. 127

³⁸ fq. 215

³⁹ fq. 214

⁴⁰ fq. 219

⁴¹ APF, SOGG, vol.715, f.241-242

⁴² APF, SOGG vol.718, f.462-464

⁴³ fq. 84

⁴⁴ fq. 51